



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.461/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryesuese, Faton Ademi dhe Ferki Xhaferi, anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Veton Berisha, kryetar i subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), paraqitur kundër Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të radhitjes së kandidatëve për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 10.11.2019, mori këtë:

VENDIM

Hudhet i palejuar apeli Anr.461/2019 i datës 08.11.2019, i paraqitur nga Veton Berisha, kryetar i subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të radhitjes së kandidatëve për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Me datë 08.11.2019 në ora 14:20, kryetari i subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), Veton Berisha, ka paraqitur në PZAP, apelin Anr.461/2019, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me përcaktimin e kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik IRDK, Elbert Krasniqi dhe sipas tyre nuk është vendim i drejtë, bazuar në nenin 111 paragrafi 1 pika b e LZP-së. Më tutje parashtruesi i apelit thekson se votat e fituara nga kandidatët që janë në listën e hapur do të duhej të zbatohesh në atë mënyrë që kandidatët e komunitetit, Egjiptian, të renditen duke u bazuar në numrin e votave të fituara për secilin kandidat, pavarësisht subjektit politik që ata/ato i takojnë, me arsyetimin se do të ishte ndarje më e drejtë dhe do të respektohet vullneti i votuesve. Po ashtu subjekti në fjalë pretendon se duke u bazuar në rezultate përfundimtare të shpallura nga KQZ-ja, numrin më të madh të votave të përgjithshme nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, i ka komuniteti Egjiptian dhe me këtë subjektit tyre PLE, kanë fituar një vend si deputet dhe një vend shtesë si deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës e ka marrë subjekti politik IRDK. Sipas tyre kjo është tërësisht e padrejtë dhe e pa pranueshme, sepse subjekti i tyre dhe kandidati për deputet nga radhët e subjekti të tyre, Veton Berisha, ka marrë më shumë vota se subjekti dhe kandidati për deputet nga IRDK, Elbert Krasniqi, dhe sipas vendimit pavarësisht votave të dy subjekteve i u është caktuar vetëm nga një vend në Kuvend. Veprim ky i cili është diskriminues ndaj vullnetit të votuesve të komunitetit Egjiptian.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj lejueshmërinë e apelit gjeti se:

Apeli është i palejuar

Paneli, konstaton se pretendimet ankimore të Veton Berishës, kryetar i subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), të parashtruara ndaj vendimit të KQZ-së, lidhur me shpërndarjen e vendeve në parlament të Kosovës, janë të palejuara që të paraqiten në PZAP, sepse PZAP-i është institucion që vendos për vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), sipas nenit 122 par.1 pikat a, b, c, d, e dhe f. Ndërsa, çështja e caktimit shpërndarjen e ulëseve të subjekteve politike në Kuvend nuk është në mandat të PZAP-it, që të shqyrtoj.

Për më tepër në nenin 63.6 të LZP-së, është paraparë që vendimi i KQZ-së, nuk i nënshtrohet ankesës, përveç nëse nuk parashihet qarte me këtë ligj. Nga kjo rezulton se, si përjashtim nga ajo çka parashihet në këtë dispozitë juridike është neni 122 par. 1 i LZP-së, ku taksativisht janë paraparë çështjet për të cilat vendimi i KQZ-së, mund të ankimohet, në mesin e të cilave nuk qëndron edhe çështja e caktimit nga ana e KQZ-së, për shpërndarjen e ulëseve të subjekteve politike në Kuvend. Megjithatë në asnjërën nga pikat e lartpërmendura të dispozitës nuk kanë rënë pretendimet e parashtruar në ankesë, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi duke u bazuar në nenin 11.5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, si dhe në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

Anr. 461/2019 më datën 10.11.2019



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.